

FORCAT E PUNËS (SASH)

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
4. Njësia matëse	5
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti	6
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	7
11. Manaxhimi i cilësisë	8
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	10
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa	11
17. Rishikimi i të dhënave.....	11
18. Përpunimi statistikor	12
19. Komente.....	13
Aneks	13

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Elma Çali
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës, Sektori i Statistikave Afatshkurtra
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri , ZIP Code, 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	ecali@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	18.03.2025
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	18.03.2025
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	18.03.2025
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Treguesit e Forcave të Punës janë tregues tremujorë afatshkurtër. Burimi kryesor për dhënat e Forcave të punës është Vrojtimi 3-mujor i Statistikave Afatshkurtra. Statistikat Afatshkurtra (SASH) paraqesin një informacion shumë të rëndësishëm mbi aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve të zgjedhura nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve dhe klasifikuar sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), të cilat operojnë në Republikën e Shqipërisë. Variablat kryesore të kërkuar në lidhje me Forcat e punës janë: Numri mesatar i të punësuarve dhe Fondi i pagave. Treguesit janë si më poshtë: INDUSTRI Treguesit e forcave të punës: • Numri mesatar i të punësuarve gjithsej; • Numri mesatar i të punësuarve me pagesë;

	• Fondi i pagave. NDËRTIM Treguesit e forcave të punës: • Numri mesatar i të punësuarve gjithsej; • Numri mesatar i të punësuarve me pagesë; • Fondi i pagave. TREGTIA ME PAKICË Treguesit e forcave të punës: • Numri mesatar i të punësuarve gjithsej; • Numri mesatar i të punësuarve me pagesë; • Fondi i pagave. SHËRBIME TË TJERA Treguesit e forcave të punës: • Numri mesatar i të punësuarve gjithsej; • Numri mesatar i të punësuarve me pagesë; • Fondi i pagave.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Nomenklatura e përdorur për Statistikat Afatshkurtra është Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike, (NVE Rev.2).
3.3. Mbulimi i sektorit	Statistikat Afatshkurtra mbulojnë të gjitha ndërmarrjet aktive në Republikën e Shqipërisë të cilat veprojnë nën aktivitetet e mëposhtme ekonomike: • INDUSTRI Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara nga seksioni B tek E të klasifikimit NVE Rev.2. B - Industri Nxjerrëse mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 05-09; C - Industri përpunuese mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 10-33; D - Energji elektrike, gaz dhe avull mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 35; E - Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 36-39. • NDËRTIMI Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në seksionin F të klasifikimit NVE Rev.2. F - Ndërtimi mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 41-43. • TREGTIA ME PAKICË Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në seksionin G të klasifikimit NVE Rev.2. G – Tregtia me pakicë mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 47.11 tek 47.78. • SHËRBIME TË TJERA Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara nga seksioni G tek N të klasifikimit NVE Rev.2.

	G - Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 45; G - Tregtia me shumicë mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 46. H - Transport dhe magazinim mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 49 tek 53. • Transporti hekurudhor mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 49; • Transporti detar mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 50; • Transporti ajror mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 51; • Magazিনি dhe aktivitete mbështetëse për transportin mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 52; • Aktivitete të postës dhe korrierës mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 53. I - Akomodimi dhe shërbimi ushqimor mbulon aktivitet ekonomike të listuara në kodin 55.10 dhe 56. • Hotel mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 55.10; • Bar Restorant mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 56. J - Informacion dhe komunikacion mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 58, 61 dhe 62. • Aktivitete publikimi mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 58; • Telekomunikacioni mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 61; • Shërbime të teknologjisë së informacionit mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 62. M - Aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 71; N - Agjenci udhëtimi mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 79.
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	Numri mesatar i të punësuarve gjithsej Indeksi i numrit mesatar të personave të punësuar gjithsej ka si objektiv të tregojë zhvillimin e punësimit. Numri mesatar i të punësuarve gjithsej është përkufizuar si numri total i personave që punojnë në njësinë e vëzhguar (duke përfshirë pronarët që punojnë, partnerë që punojnë rregullisht në njësi dhe pjestarët e familjes që punojnë, por nuk paguhen), si dhe i personave që punojnë jashtë njësisë, por që i përkasin asaj dhe që paguhen nga ajo (psh. përfaqësuesit e shitjeve, personeli i shpërndarjes, skuadra e riparimit dhe e mirëmbajtjes). Numri mesatar i të punësuarve me pagesë Janë të gjithë personat që punojnë për llogari të punëdhënësit kundrejt një page për punën që kryejnë. Fondi pagave Indeksi i fondit të pagave ka për objektiv të tregojë ecurinë e kostove gjithsej

	të personelit. Pagat janë përkufizuar si shpërblimi total në monedhë ose në natyrë, të paguar të gjithë personave të shënuar në listën e pagave (duke përfshirë dhe ato që punojnë në shtëpi) si shpërblim i punës së bërë gjatë periudhës së llogaritur pavarësisht nëse është paguar në bazë të kohës së punës, prodhimit apo punës me pjesë dhe nëse është paguar rregullisht ose jo).
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është Ndërmarrja. Në rastet kur ndërmarrja ushtron më shumë se një aktivitet ekonomik, zbatohet njësia e llojit të aktivitetit (KAU).
3.6. Popullata statistikore	Popullsia statistikore përfshin njësinë statistikore, ndërmarrjet aktive në periudhën referuese, të cilat operojnë në aktivitetet ekonomike sipas NVE Rev.2, Industri (seksionet B, C, D dhe E, përkatësisht ndarjet 05-39); Ndërtim (seksioni F, ndarjet 41-43); Tregti (seksioni G, ndarjet 45-47); Shërbime (seksioni H, ndarjet 49-53; seksioni I, ndarja 55.10 dhe 56; seksioni J, ndarjet 58, 61 dhe 62; seksioni M, ndarja 71; seksioni N, ndarja 79). Ndërmarrjet me 1- 9 të punësuar janë anketuar me mostër, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar në mënyrë shteruese.
3.7. Zona e referencës	Statistikat mbi Forcat e Punës mbulojnë të gjithë territorin e Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Vrojtimi tremujor i Statistikave Afatshkurtra referuar statistikave mbi Forcat e Punës datojnë prej vitit 2003 në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Duke filluar nga tremujori i parë 2024, aplikohet viti bazë 2021 (2021 = 100).
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	Njësitë matëse janë indekset dhe ndryshimet në përqindje.
5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Informacioni i grumbulluar dhe përpunuar nga Statistikat Afatshkurtra i referohet periudhave tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2024.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore në nivel kombëtar: • Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026 Klasifikimet dhe Përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE: • Rregullorja (BE) 2019/2152 për Statistikat Evropiane të Biznesit; • Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2020/1197 e cila përcakton variablat dhe shpeshësinë e përpilimit të të dhënave, shfuqizimi i porosive të reja të marra për ndërtimin e ndërtesave dhe urdhërat e reja të marra për inxhinierinë civile.

6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Nga tremujori i parë 2018 treguesit kryesorë të Statistikave Afatshkurtra, siç janë treguesit e Forcave të punës transmetohen rregullisht në Eurostat .
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga ndërmarrjet konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare , si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikën zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë e ofrimit të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë nënkupton kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur procesi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësive statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se: a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor ose; b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave. Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to dhe ato të ngarkuar të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësive statistikore të vërtetuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për kërkuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.

8.2. Akses në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: • Website online release; • Kërkesat e shkruara; • Publikimi; • Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes	Treguesit e Forcave të Punës shpërndahen me bazë 3-mujore.
10. Akses në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Sipas kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Statistikat Afatshkurtra (treguesit e Forcave të Punës). Format i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Statistikave Afatshkurtra (treguesve mbi Forcat e Punës) publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet gjenden të botuara në faqen e internetit të INSTAT, nën temën: Statistikat Afatshkurtra .
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e Statistikave Afatshkurtra. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: Databaza Statistikore .
10.4. Akses në të dhënat mikro	Të dhënat në nivel mikro nuk bëhen të disponueshme, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018, datë 17.04.2018 "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kontakt .

10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodologjinë mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ATN për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në përpilimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” , INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Kontrollet e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi ka përvojën e duhur për përllogaritjen e indeksit dhe i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të tij, të tilla si: mbledhja e të dhënave, kontrollet fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollet përfundimtare. Është bërë një krahasim me të dhënat e vitit të kaluar për të parë nëse ka ndonjë koherencë të të dhënave apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha. Në rast ndryshimesh, të dhënat administrative përdoren për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen ndryshime të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit janë klasifikuar në të jashtëm dhe të brendshëm. Përdoruesit e jashtëm janë: - Ministritë dhe administrata publike që përdorin të dhënat për qëllime të planifikimit të politikave ekonomike dhe sociale; - Universitetet (profesorë / studentë të diplomuar dhe pasuniversitar), organizata kërkimore; - OJQ Kombëtare dhe Ndërkombëtare; - Ndërmarrjet; - Publiku i gjerë që merr informacionin përmes mediave masive përmes publikimeve të bëra nga Zyra e Statistikave.

	Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT: • Drejtoria e Llogarive Kombëtare; • Sektori i Regjistrat Statistikor të Ndërmarrjeve; • Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT kryen çdo vit vërtetimin për Matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve, rezultatet e të cilit publikohen në web në linkun: Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve. Rezultatet e vërtetimit për 2024 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës "Forcat e Punës" është vlerësuar me 3.83 (76.6 %) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).
12.3. Plotshmëria	Për sa i përket plotshmërisë së Statistikave Afatshkurtra, këto ndërtohen në përputhje me rregulloret e Eurostat. Shkalla e plotshmërisë së të dhënave në lidhje me treguesit e Forcave të Punës, për vërtetimin e Statistikave Afatshkurtra për vitin 2024 është 62,0 %. Kjo llogaritje bazohet duke marrë parasysh raportin e kërkesave të përmbushura nga INSTAT (rreth treguesve të Forcave të Punës) kundrejt atyre që kërkohet nga rregulloret Evropiane.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime të dhënave të anketës kontrollohen me pasqyrat financiare ose me burime administrative nëse ka informacion. Popullata e vëzhguar e Statistikave Afatshkurtra 2024 përfshin afërsisht 11,000 ndërmarrje për çdo tremujor. Dizanji i kampionimit është kampionim i thjeshtë i rastësishëm, i shtresëzuar. Kriteri i përdorur për shtresëzim është numri i punonjësve sipas NVE Rev.2 në nivel 3 shifror. Llogaritja e vlerësimeve të të dhënave statistikore dhe analiza e njësive outlier kryhet rregullisht. Shkalla e saktësisë së përgjithshme është e lartë, duke marrë parasysh shkallën e lartë të përgjigjes. Për të llogaritur vlerësimet, përdoret vlerësuesi Horvitz-Thompson, që është i paanshëm. Saktësia e vlerësimeve arrihet duke eliminuar gabimet e kampionimit dhe të jo kampionimit, të tilla si mbulimi, pa përgjigje, gabimet e përgjigjes dhe gabimet e përpunimit. Arsyet e shfaqes së gabimeve në mbulimit janë keq klasifikimi i njësive dhe ndryshimet në statusin e njësive raportuese. Është e detyrueshme t'i përgjigjesh vërtetimit. Në rast mos-përgjigje, njësitë kontaktohen përmes telefonit dhe postës elektronike. Gabimi në kampionim në përqindje (CV) llogaritet për treguesit kryesorë të vërtetimit që publikohen çdo tremujor.
13.2. Gabim i kampionimit	Gabimet e kampionimit trajtohen në raportet e brendshme teknike, ku për çdo indikator në vërtetim llogaritet varianca e totalit, si dhe gabimi standart relativ, për eliminimin e efektit negativ që jep lëvizja e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes në serinë kohore të vlerave. Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim.

13.3. Gabim jo i kampionimit	Gabimet jo për shkak të kampionimit për treguesit e Forcave të Punës janë kryesisht për shkak të gabimit të mos-përgjigjes. Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Prandaj, sektori i Statistikave Afatshkurtra shfrytëzon të dhënat administrative dhe teknika të mira të vlerësimit kur është e nevojshme.								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	Treguesit e Forcave të Punës për 2024 janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 77 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+77 ditë). Periudha referuese e rezultateve është 31 Dhjetori 2024. <table border="1" data-bbox="453 669 895 808"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2024</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>3/18/2025</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>77</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2024	Data e publikimit	3/18/2025	Afatet kohore	77		
Periudha referuese	12/31/2024								
Data e publikimit	3/18/2025								
Afatet kohore	77								
14.2. Përpikmëria	Treguesit e Forcave të Punës publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i rezultateve mbi Treguesit e Forcave të Punës ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve. <table border="1" data-bbox="453 956 895 1106"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2024</td></tr> <tr> <td>Data e shpallur</td><td>3/18/2025</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>3/18/2025</td></tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td><td>0</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2024	Data e shpallur	3/18/2025	Data e publikimit	3/18/2025	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2024								
Data e shpallur	3/18/2025								
Data e publikimit	3/18/2025								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahaseshmëria									
15.1. Krahaseshmëria gjeografike	Të dhënat mbi treguesit e Statistikave Afatshkurtra, siç janë treguesit e Forcave të Punës janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat dhe si të tilla janë të krahaseshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithë përfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi.								
15.2. Krahaseshmëria kohore	Ndër vite Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve e Statistikave Afatshkurtra ka pësuar ndryshime në fushën e mbulimit dhe në metodën e zgjedhjes. ATN ka filluar për herë të parë në vitin 2003. Në vitin 2005 është shtuar aktiviteti i Tregtisë me shumicë. Në vitin 2008 metoda e kampionimit kalon nga metoda me listim në metodën e kombinuar (me kampionim dhe listim). Ndërmarrjet më 1-9 të punësuar janë me kampionim, ndërsa ndërmarrjet me mbi 10 të punësuar janë marrë me listim (në mënyrë ekzostive) pa ndryshuar fushën e mbulimit. Në vitin 2012 ndryshon popullsia e ATN si rezultat i përditësimit të Rregjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve me rezultatet e Rregjistrimit të Ndërmarrjeve Ekonomike, 2010. Në vitin 2014 në Statistikat Afatshkurtra implementohet Nomenklatura e Re e Aktiviteteve Ekonomike, NVE REv.2, përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2005 në 2010. Në vitin 2019 periudha bazë e indekseve ndryshoi nga 2010 në 2015. Në vitin 2024 në Statistikat Afatshkurtra përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2015 në 2021. Në të gjitha këto ndryshime seritë e indekseve nuk janë shpëputur, por indekset janë								

	përditësuar për të reflektuar ndryshimet. Të gjitha ndryshimet janë raportuar në Shpjegimet metodologjike që shoqërojnë publikimet përkatëse. Të dhënat e Statistikave afatshkurtra sipas tremujorëve bazuar në Klasifikimin e Aktivitetit Ekonomik NVE Rev 2, datojnë që nga viti 2006 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 19 vitesh (CC2=Jlast- Jfirst+1=19). Të dhënave ju bëhen kontrolle të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Të dhënat kontrollohen me burimet administrative me bazë tremujore. Pas këtyre kontrolleve mund të konkludohet se të dhënat janë koherente.
15.4. Koherenca e brendshme	Koherenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar përpara se ato të finalizohen. Lidhja midis variablave është kontrolluar dhe koherenca midis serive të ndryshme të të dhënave është konfirmuar. Specialistët e Statistikave Afatshkurtra punojnë së bashku me specialistë të drejtorive përkatëse për të siguruar qëndrueshmërinë dhe koherencë të treguesve statistikor.
16. Kostoja dhe ngarkesa	
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	Kostoja e Statistikave Afatshkurtra përfshin informacion mbi numrin e stafit të përhershëm dhe të përkohshëm. Numri i stafit të ATN-së është: • Totali i stafit në Zyrën Qendrore: 4 punonjës; • Specialistët e logjistikës 1 punonjës; • Anketues 144 të punësuar; • Kontrollorë 9 të punësuar. Transmetimi i të dhënave administrative mundësohet pa kosto përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara midis INSTAT, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Burimet Statistikore si (Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ATN e mëparshme) janë gjithashtu pa kosto, pasi janë konsideruar si përdorues të brëndshëm. Stafi i ATN menaxhon kontrollin dhe analizën e të dhënave, kështu që edhe këto dy procese nuk kanë kosto të tjera shtesë.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit të ATN-së bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë: • Politika e revizionimit; • Politika e trajtimit të gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	Të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare ato mund të rishikohen. Të dhënat mund të rishikohen për një sërë arsyesh si: implementimi i klasifikimit të ri NVE, ndryshime metodologjike, burime të reja informacioni ose të përmirësimeve të të dhënave dhe korrigjime të gabimeve. Rishikimi i tremujorit paraardhës është i mundur të kryhet gjatë çdo

	tremujori dhe në fund të çdo viti mund të kryhen korrigjime për të katërt tremujorët. Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Forcat e Punës” për vitin 2024, subjekt i këtij raporti. Nuk ka vleresime numerike të indikatorëve MR dhe MAR.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Të dhënat mbi Statistikat Afatshkurtra bazohen në anketat statistikore tremujore. Baza e përzgjedhjes është Regjistri i ndërmarrjeve aktive për vitin referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, NVE Rev. 2. Popullata në studim përcaktohet nga dy kriteret themelore: Madhësia e ndërmarrjes (bazuar në numrin e të punësuarve) dhe aktiviteti ekonomik brenda fushës së studimit, me prerje. Metoda e përzgjedhjes së përdorur është Përzgjedhje e thjeshtë e Rastit me Shtresëzim (SRS). Shtresëzimi bazohet në kombinimin e aktivitetit ekonomik me grupin e madhësisë së ndërmarrjes. Treguesit janë paraqitur për aktivitete ekonomike sipas fushave të përcaktuara në rregulloren e Statistikave Afatshkurtra dhe gjithashtu bazuar në nevojat e përdoruesve.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mbledhen çdo tremujor.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Gjatë vitit 2024, të dhënat janë siguruar në mënyrë të kombinuar nëpërmjet burimeve administrative dhe të dhënave të mbledhura drejtpërdrejtë nga sipërmarrjet me intervistë të drejtpërdrejtë. Të dhënat e anketuara mbledhen nga intervistat me pyetësorin në letër në bazë tremujore, 15 ditë pas përfundimit të perjudhës referuese. Kohësgjatja e këtij sondazhi është 15 ditë pune. Nuk janë planifikuar ndryshime në pyetësoret kombëtar.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënat e marra nga vrojtimi dhe nga skedari i Listë pagesës (i përdorur për imputim) vlerësohen duke përdorur rregulla logjike të vlefshme. Në nivel kombëtar, editimi përfshin studimin e të dhënave të të anketuarve me qëllim identifikimin (dhe korrigjimin) e gabimeve. Jo të gjitha gabimet mund të identifikohen, por qëllimi është të zbulohen ato gabime që kanë ndikim të madh tek rezultatet. Rregullat për identifikimin e gabimeve mund të vënë në dukje gabime të mundshme të cilat kërkojnë një studim të mëtejshëm për të kuptuar se ku qëndron gabimi përkundrejt një rezultati të pazakontë ose mund të evidentojnë gabime të përcaktuara. Redaktimi (editimi) përfshin kontrollin për tërësinë, që vlerat janë brenda kufijve të caktuar dhe se vlerat për variablat e lidhur janë koherente. Redaktimi i të dhënave mund të bëhet gjatë ose pas hedhjes së të dhënave. Përgjigjet mund të krahasohen me përgjigjet e tremujorëve të mëparshëm. Mospërputhja ose devijimet e mëdha (jashtë një diapazoni të paracaktuar) tregojnë se një studim më i thellë do ishte i rëndësishëm. Kjo mund të rezultojë në redaktim të dhënash. Në kontekstin e afatit kohor, procesi i redaktimit mund të jetë i dizajnuar për t'i dhënë përparësi kryesore atyre njësive outlier që kanë

	më shumë nevojë për redaktim për hir të aggregateve të besueshëm. Me zgjidhjen e rasteve më të këqija, mund të arrihen përmirësime të mëdha.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nivel Kombëtar Hapi i parë është mbledhja e informacionit nga burimet administrative dhe intervista me telefon të ndërmarrjeve. Qëllimi është për të sjellë këtë informacion në nivelin statistikor. Proçesi i ndjekur është si vijon: • Kontrolli logjik i informacionit të mbledhur me intervista në telefon (kontrolli i shënjimit logjik të indikatorëve të përgjigjes si dhe kontrolli i plotësimit të shifrave); • Pas hedhjes së të dhënave, gabimet dhe mospërputhjet evidentohen dhe korrigjohen përgjatë redaktimit (editimit); • Krahasueshmëria e të dhënave (analizë e të dhënave me periudhat e mëparshme ose trendet); • Analiza e rezultateve për çdo fushë publikimi (domein); • Rezultatet e plota dhe të pastra të të dhënave shërbejnë më pas për fazën e peshimit dhe ri-peshimit; • Të dhënat e agreguara krahasohen me të dhëna nga burime të tjera; • Dy fazat e fundit mund të jenë subjekt analizash të tjera, në funksion të rezultateve sipas fushave të publikimit (domein-et). Së fundi, kur analiza statistikore ka përfunduar, këto të dhëna përcaktohen si grup informacioni jo-publike. Para shpërndarjes së rezultateve, fazë shumë e rëndësishme është ruajtja e konfidencialitetit të këtij informacioni.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet. Asnjë rregullim (përshtatje sezonale) nuk është bërë për variablin e punësimit dhe variablin e fondit të pagave.
19. Komentë	Kjo metadatë bashkon të gjitha variablat që lidhen me Punësimin (punësimin dhe fondin e pagave) për të gjitha fushat e Statistikave Afatshkurtra (Industri, Ndërtim, Tregtia me pakicë dhe Shërbime).
Aneks	